



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1031 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2022

VENDIM
Nr. 427, datë 24.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani në kuadër të projektit *“Green Coast Resort - 2” Zonat g5, g6a, g7a, g9, dhe g10*, Himarë, me aplikues dhe zhvillues Seaside Residence I;
2. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit 27 datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

